

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“As TRANSPORTE” SH.P.K.

Në Tiranë sot më datë 28/10/2021 (dymije e njezete e nje), themeluesi,

Znj. Gentiana Askushaj, lindur më 06 Qershori 1983 në Burrel dhe banues ne Tirane, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtës i leternjoftimit me numer 031725070 dhe numer personal I35606081S madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

I cili duke u bazuar dhe në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, ‘Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare’ , ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshte “Shoqeria”), me dispozitat e mëposhtme.

Neni 1

Emërtimi dhe selia e shoqërise

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësai të kufizuar është “**As TRANSPORTE**” Shpk.

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë ne adresen Rruga Kasem Shima nr 36, ZK 2679, Mezez, Tirane, Shqiperi. Në këtë adresë ndodhet edhe Zyra Qëndrore e Shoqërise.

1.1 Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Objekti i Shoqërisë

2.1 Objekti i Shoqërisë është :

Transport I per gjithshem mallrash dhe udhetarash, urban dhe interurban, kombetar dhe nderkombetar, per vete dhe per te trete. Tregtim makineri e pajisje e automjete te ndryshme si dhe pjese kembimi per to, i artikujve industrial, elektroshtepiake, veshmbathje e konfesione, lende ndertimi si dhe cdo lloj artikulli tjeter me objekt shit blerje me shumice dhe pakice ne export dhe import. Investime ne fushen e industrise ushqimore, servis lavazh dhe grumbullim skrabi dhe tregtim makineri pajisje buqesore

Aktiviteti i shoqerise nuk do te kufizohet vetem ne keto sherbime apo veprimtari.

2.2 Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara mund të bashkëpunojë me direk dhe indirekt me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt analog osë të lidhur me të tyren.

Neni 3

Kohëzgjatja e Shoqërise. Viti ushtrimor

3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat te pacaktuar.


3.2 Viti i parë finanziar do të fillojë nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë dhe do të përfundojë në 31 Dhjetor.

3.3 Vitet e mëtejshme financiare fillojnë më 1 Janar dhe përfundojnë me 31 Dhjetor.

Neni 4

Kapitali themeltar

4.1 Kapitali fillestar i nënshkruar dhe i paguar i shoqërisë është 100 (njeqind leke) dhe përbëhet tëresisht nga kapital në para. Kapitali themeltar perbehet nga 1 (një) kuota me vlerë nominale të barabartë prej 100 (njeqind leke)Lekë



4.2 Në bazë të kontributit të paguar, pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin themeltar eshte Znj. Gentiana Askushaj zoteron 100% te kuotave te kapitalit themeltar ose 1(nje) kuote.

Neni 5

Asambleja e Përgjithshme

5.1 Asambleja e përgjithshme ëhstë përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për cështjet e përcaktuara në Ligjin per Shoqerte tregtare . Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet dhe sipas mënyrës së thirrjes të përcaktuara në statusin e shoqërisë.

Neni 6

Administratori

6.1 Shoqëria do të administrohet nga një Adminstrator. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë Znj. Gentiana Askushaj. Afati i emërimit të Administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje.

Neni 7

Kostot e themelimit

7.1 Të gjitha kostot, pagesat dhe shpenzimet lidhur me themelin dhe regjistrimin e shoqërisë do të merren përsipër nga shoqëria të cilat do të përfshihen në llogarinë e parë vjetore financiare në shumën e atyre aktuale.

Neni 8

Njoftimet

8.1 Njoftimet për oratakët do të kryhen me postë të regjistruar në adresën e kompanise më të fundit të komunikuar nga cdo ortak, me përjashtim kur parashikohet ndryshe nga ligji apo statuti.

8.2 Njoftimi mund të bëhet edhe nëpërmjet postës elektronike, në momentin e krijimit të ksuheteve teknike që kërkohen sipas ligjit.

Neni 9

Dispozita të fundit

9.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përpunje me këtë akt themeli, me statutin e saj dhe ligjin shqiptar.

Neni 10

Kopje

10.1 Ky akt themeli hartohet në 3 kopje, sipas këtij destinacioni, një kopje orataku, një kopje për Qëndrën Tregtare të biznesit dhe një kopje për zyrën qëndrore të shoqërisë.

**ORTAKU THEMELUES
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“As TRANSPORTE” SH.P.K.
Z. Gentiana Askushaj**

Gentiana Askushaj 